



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3468/prot.
16

Pogradec, më 30.08.2024

VENDIM

NR. 89, DATË 29.08.2024

PËR

"DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 133, DATË 11.12.2023,
PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË
POGRADEC"

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr.44/2015, "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr.115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



[Handwritten signature]

1. Të miratojë disa shtesa në pikën II.16 “ Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe” të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 11.12.2023, për “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec”, si më poshtë:

II.16 Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe:

Tarifë për kopshtet	Njësi	Vlerë
Tarifë për kopshte	Kuota mujore lekë/fëmije	3960
Tarifë për çerdhet	Njësi	Vlerë
Tarifë për çerdhet	Kuota mujore lekë/fëmije	3300

II.16.1. Efektet financiare fillojnë menjëherë me fillimin e vitit të ri mësimor 2024-2025.

II.16.2. Ngarkohet Qendra Arsimore për vjeljen e kësaj tarife ku pagesa kryhet pranë Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

II.16.3. Në rast se fëmija mungon në kopsht ose çerdhe 5 ose më shumë ditë të cilat do të jenë të justifikuara me raport, këto ditë do të zbriten nga vlera mujore që prindi ka detyrim të paguajë.

II.16.4. Në rastet kur fëmija mungon gjatë gjithë muajit prindi nuk ka asnjë detyrim për të paguar.

II.16.5. Lidhja e kontratës midis drejtorisë së kopshteve/çerdhes dhe prindit të fëmijës.

2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” ,i ndryshuar).

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 16 vota

2.Vota Pro 16

3.Vota Kundër 4

4.Vota Abstenim 5

5.Zbardhur më date 30.08.2024

